

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

Në hyrje të këtij raporti paraqitet Harta e Stabilitetit Financiar, e cila tregon shpërndarjen e rrezikut tek faktorët që ndikojnë stabilitetin e sistemit financiar. Këta faktorë përfshijnë mjedisin ekonomik rrethues, të brendshëm e të jashtëm, sektorin bankar, si dhe agjentët e ekonomisë reale: qeverinë, bizneset dhe individët.

- (1) Për fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, harta tregon një rritje të lehtë të rreziqeve në mjedisin ekonomik të jashtëm, ndërsa rreziqet në mjedisin ekonomik të brendshëm që lidhen me veprimtarinë bankare dhe agjentët e ekonomisë reale, kanë lëvizur në kahe të ndryshme. Në një analizë ku zhvillimet shihen si të veçuara, vlera e treguesve sugjeron që rreziku për kategoritë e "individëve" dhe "ekonomisë së brendshme", si pjesë e mjedisit ekonomik rrethues, ka ardhur në rënie, si rezultat i zhvillimeve pozitive në ecurinë e treguesve makroekonomikë dhe financiarë gjatë periudhës. Në të kundërt, treguesit e veprimtarisë bankare, që lidhen me "strukturën e sektorit bankar" dhe "likuiditetin dhe financimin", sugjerojnë një rritje të lehtë të rrezikut.

Më konkretisht,

a. në mjedisin e përgjithshëm ekonomik vërehet që:


- i. rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie, në vijim të ngushtimit të hendekut të prodhimit dhe rënies së madhësisë së stokut të borxhit të jashtëm ndaj PBB-së;
- ii. rreziku që vjen nga "mjedisi i jashtëm" vlerësohet sërish "mesatar", por në rritje të lehtë gjatë periudhës, ndikuar nga zbutja e ritmit të rritjes ekonomike të partnerëve tanë tregtarë, rritja e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare dhe rritja e normave afatshkurtra të interesit në tregjet e parasë⁷, kryesisht si rezultat i normalizimit të politikës monetare të Rezervës Federale të SHBA-ve.

b. tek agjentët e ekonomisë reale, vërehet që:

⁷ Treguesi i lidhur me normat afatshkurtra të interesit llogaritet si mesatare e thjeshtë e normave 3-mujore të LIBOR-it dhe EURIBOR-it në tregjet ndërkombëtare, që përafrojnë kostot me të cilat bankat tona sigurojnë fonde nga bankat e huaja dhe grupet bankare zotëruese. Rritja e këtyre normave nënkupton rritjen e rrezikut të financimit në tregjet e huaja.



Grafik 1.1 Harta e stabilitetit financiar



**Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut. Burimi: Banka e Shqipërisë.

i. rreziku nga "individët", vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, në sajë të përmirësimit të normës së regjistruar të papunësisë, cilësisë së portofolit të kredisë për individë, si edhe të dërgesave të emigrantëve;

ii. rreziku nga "bizneset" vlerësohet "mesatar", por në rritje, në kushtet e përkeqësimit të kredithënies kundrejt prirjes së saj afatgjatë për këtë kategori, pritisshmërive afatshkurtra të bizneseve dhe indeksit të gjendjes së tyre financiare;


iii. për "qeverinë", niveli i rrezikut vijon të vlerësohet "i ulët" dhe i pandryshuar, duke shprehur një qëndrueshmëri fiskale për periudhën.

c. ndërsa, në veprimtarinë e sektorit bankar vërehet që:

- i. niveli i rrezikut nga "kapitalizimi dhe përfitueshmëria" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie gjatë periudhës. Përmirësimi i kapitalizimit të sektorit dhe cilësisë së kredisë nga njëra anë dhe rritja e lehtë e të ardhurave para taksave në raport me aktivet e sektorit nga ana tjetër, kanë kontribuar në uljen e mëtejshme të rrezikut nga kjo kategori;
- ii. rreziku nga "likuiditeti dhe financimi" vlerësohet "i moderuar" dhe me prirje të lehtë rritëse. Ky zhvillim reflekton thellimin e hendekut midis aktiveve dhe pasiveve të bankave me afat deri në 3 muaj⁸, ngadalësimin e mëtejshëm të rritjes së depozitave të individëve, si dhe një rritje të lehtë të financimit nga jorezidentët. Pavarësisht sa më lart, treguesi i likuiditetit të sektorit mbetet në nivele të kënaqshme, në mbështetje të aktivitetit bankar;
- iii. së fundi, niveli i rrezikut që lidhet me "strukturën e sektorit bankar", vlerësohet "i ulët", por në rritje krahasuar me një vit më parë, si rezultat i një shpërndarjeje më të gjerë të kapitalizimit të bankave, krahasuar me mesataren e sektorit, dhe rritjes së përqendrimit të huadhënies për sektorin e biznesit.


Hapësira informuese 1.1 paraqet të gjithë përbërësit e kategorive të Hartës së Stabilitetit Financiar gjatë gjysmës së parë të vitit 2018, vlerësimet me "notë" për nivelin e rrezikut për secilin përbërës dhe krahasimin me vlerësimin e një viti më parë.

⁸ Brenda kësaj kategorie, e cila përgjithësisht është vlerësuar me rrezik të ulët, thellimi i hendekut është rrjedhojë kryesisht e ndryshimit të përkufizimit të tij për qëllime të analizave më të hollësishme nga autoriteti mbikëqyrës.




HAPËSIRË INFORMUESE 1.1. PËRBËRËSIT E HARTËS SË STABILITETIT FINANCIAR


Rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie, për shkak të zvogëlimit të hendekut të prodhimit, nevojave për financim të jashtëm dhe rënies së lehtë të madhësisë së borxhit të jashtëm.




Rreziku për "individët" vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, për shkak të përmirësimit të cilësisë së portofolit të individëve, uljes së normës së papunësisë dhe rritjes së dërgesave të emigrantëve.




Rreziku për "bizneset" vlerësohet "mesatar" por në rritje, duke reflektuar zhvillimet në huamarrjen e sektorit privat, pritishtëritë e bizneseve dhe indeksin e gjendjes financiare të tyre.




Rreziku që vjen nga "qeveria" vlerësohet "i ulët" dhe i pandryshuar, duke ruajtur të njëjtin vlerësim për të gjithë treguesit, në krahasim me një vit më parë.




Rreziku nga "mjedisi i jashtëm" vlerësohet "mesatar" dhe në rritje, ndikuar nga ngadalësimi i rritjes ekonomike të partnerëve tregtarë, rritja e çmimeve të nafës në tregjet ndërkombëtare dhe rritja e mesatares së normave atashkurtra të interesit (Euribor, Libor 3-mujor) në tregjet e pasasë.




Niveli i rrezikut nga "kapitali dhe përfitueshmëria" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie. Rritja e kapitalizimit të sektorit bankar, përmirësimi i cilësisë së kredive dhe rritja e të ardhurave para taksave në raport me totalin e aktiveve, kanë ndikuar në zbutjen e rrezikut nga kjo kategori.



Rreziku që vjen nga "financimi dhe likuiditeti" ka rezultuar në nivelin "i moderuar" dhe në rritje, si rrjedhojë e thellimit të hendekut midis aktiveve dhe pasiveve atashkurtra deri në 3 muaj dhe rritjes së financimit nga jorezidentët.



Rreziku nga "struktura e sektorit bankar" mbetet i ulët, por në rritje gjatë periudhës, pasi diferenca e vlerave me të ulëta me vlerën mesatare të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit është zgjeruar, dhe përqendrimi i huadhënies për sektorin e biznesit është rritur.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë.



1.1 RREZIKU SISTEMIK⁹


Vlerësimi i ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik kryhet duke analizuar ecurinë e treguesve që lidhen me: a) materializimin dhe akumulimin e rrezikut sistemik; b) nivelin e stresit në sistemin financiar; c) perceptimin e industrisë bankare mbi ekspozimin e veprimtarisë së saj ndaj rreziqeve sistematike.

Indeksi i materializimit të rrezikut sistemik ofron një vlerësim lidhur me nivelin aktual të rrezikut, ndërsa indekset e akumulimit të rrezikut, të stresit financiar dhe të perceptimit të industrisë bankare rreth tij, fokusohen kryesisht drejt së ardhmes.

(2) **Materializimi i rrezikut sistemik ka vijuar rënien gjatë periudhës.** Në këtë ecuri të indeksit kanë ndikuar përmirësimi i cilësisë së kredisë për individët, rënia e nivelit të papunësisë në vend, si dhe ecuria e kursit të këmbimit (Grafik 1.2). Akumulimi i rrezikut sistemik ka qenë i qëndrueshëm gjatë periudhës, ku kontributi në rritje të indeksit nga zgjerimi i borxhit të individëve dhe rritja e vlerës së kredive të ndjeshme ndaj luhatjeve të normës së interesit, është kompensuar nga kontributi në ulje të tij prej rënies së borxhit publik dhe segmentit të borxhit të jashtëm.


(3) **Indeksi i stresit financiar ka rezultuar në rritje,** kryesisht për shkak të ngadalësimit të ecurisë së treguesve të sektorit bankar - depozitat, kreditë dhe marzhi neto të interesave - ndaj prirjes së tyre historike (Grafik 1.3).

Grafik 1.2. Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 1.3. Indeksi i Stresit Financiar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

⁹ Rreziku sistemik përcaktohet si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia të ndikohen në mënyrë materiale".



(4) Perceptimi i industrisë bankare mbi rreziqet sistemike nuk ka paraqitur ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës. Në nivel perceptimi “mesatar”, mbeten rreziqet për “përkeqësimin e ekonomisë” dhe për “ekzekutimin e kolateraleve”. Në nivel perceptimi “të ulët”, por me rritje gjatë periudhës, paraqiten perceptimet mbi rreziqet që lidhen me “kreditimin” dhe “paqëndrueshmërinë e vlerës së pasurive të paluajtshme”. Gjatë periudhës, është vënë re një rritje e perceptimit të bankave lidhur me rrezikun nga “kursi i këmbimit”, pavarësisht se nuk është klasifikuar në grupin e pesë rreziqeve më të rëndësishme sistemike në vend. Mbiçmimi i lekut kundrejt valutave kryesore (veçanërisht ndaj euros) gjatë periudhës, duket se ka ndikuar në rritjen e vëmendjes së bankave ndaj këtij fenomeni dhe qëndrueshmërisë së tij.

Grafik 1.4 Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike



Burimi: Banka e Shqipërisë.

